



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 11 (827815)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 17 mars 2023

Intervistë me mësuesen Zamira Dedej/ Mirënjohje pafund për pishtarët e palodhur të dijes

Në radhën e gjeneratës së mrekullueshme të mësuesve të shkollës "Skënderbej", bën pjesë mësuese Zamira Dedej, një prej atyre që lanë gjurmë të rëndësishme në edukimin dhe mësimin e skënderbegasve të disa brezave. Si mësuese, ajo gjendej gjithnjë pranë nxënësve për të ndihmuar ata që hasnin vështirësi e për të mundësuar asimilimin më të lehtë të lëndës. Mësuese Zamira është ndër mësueset e përzgjedhura që afrohet për të dhënë mësim në Shkollën e Mesme të

Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej". Në këtë periudhë, kjo shkollë ishte konsoliduar me kuadro mësimdhënës e oficerë komandues nga më të mirët dhe kishte shtuar ndjeshëm numrin e nxënësve që studionin në të. Pjesë e këtij kolektivi mësimdhënësish e komanduesish, bëhet dhe Zamira. Janë shumë breza skënderbegasish të këtyre viteve, që ruajnë respektin më të madh për mësuesen e tyre Zamirën. Ata kujtojnë pasionin e saj për orën e mësimin, gatishmërinë për t'i ndihmuar në

kohën e lirë, përpjekjet e saj për të evidencuar e përkrahur talente, të cilët shkëlqyen në rrugëtimin e tyre. Mësuese Zamira Dedej vjen për lexuesin tonë nëpërmjet kujtimeve 40-vjeçare të saj, mes nxënësish që për të ishin dhe bij. Kur keni filluar punën në arsim dhe si ju ka ngelur në kujtesë ajo kohë, dita e parë kur keni marrë ditarin në dorë, ditë që nuk harrohet kurrë? Vitet që unë kam dhënë mësim në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake, zënë një vend... >>> faqe 6



Takimi i 10-të i Grupit të Kontaktit për Ukrainën



Ministri Peleshi:
Në unitet me partnerët tanë, për të vijuar ndihmën në emër të lirisë dhe të drejtës së jetës në Ukrainë

>>> faqe 3

SHSHPFA, gjeneral brigade Kingji priti atasheun ushtarak të Turqisë, kolonel Kablay

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak të Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay. Atasheu turk përcolli falënderimet dhe konsideratat më të larta në emër të shefit të Shtabit të Ushtrisë turke, për Forcat e Armatosura Shqiptare dhe lidhshimin e saj, duke qenë ndër të parët që reagon dhe u mobilizuan në dërgimin e ekipeve të kërkim - shpëtimit në zonat e prekura nga tërmeti shkatërrimtar në Turqi. "Shpallja e ditës së zisë kombëtare në Shqipëri ishte një refleksion...



>>> Faqe 2

E kaluara rrënjë e trungut, e tashmja fruti, e ardhmja fara

Në shumë njerëz realiteti i ngjërave është aktualiteti i tyre, gjërat janë ashtu sikurse i shohim në një moment të caktuar. Në përgjithësi njerëzit priren të besojnë tek njohja e tyre për aktualitetin, për atë që ndodh përpara syve të tyre dhe ajo që e përjetojnë vetë është maksimumi i njohjes së tij. Kjo bindje shprehet në mënyra të ndryshme, por kryesisht në idenë se e kaluara nuk na intereson shumë, se ka kaluar tashmë, kurse e ardhmja, po ashtu nuk mund të parashihet dhe as të jetohet me ankthin...



>>> Faqe 8

Kolonel Selim Shiroka, "dëshmia" e punës së pasionuar dhe plot dinjitet

Kolonel Shiroka lindi në Vlorë në qytetin 1951. Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej" e mbaroi në vitin 1969 në Tiranë. Në vitin 1972 mbaroi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në specialitetin radiozbulim. Përfundon kursin e Lartë trevjeçar të Zbulimit në kriptologji, kriptanalizë dhe përpunim informacioni në vitet 1974. Në vitin 1996 mbaroi Kolegjin e Mbrojtjes në Tiranë. Në vitin 1997 kualifikohet në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë, Itali. Është kualifikuar në seminare dhe trajnime në SHBA...



>>> Faqe 15

SHSHPFA, gjeneral brigade Kingji priti atasheun ushtarak të Turqisë, kolonel Kablay

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak të Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay.

Atasheu turk përcolli falënderimet dhe konsideratat më të larta në emër të shefit të Shtabit të Ushtrisë turke, për Forcat e Armatosura Shqiptare dhe lidhshimin e saj, duke qenë ndër të parët që reaguan dhe u mobilizuan në dërgimin e ekipeve të kërkim - shpëtimit në zonat e prekura nga tërmeti shkatërrimtar në Turqi. "Shpallja e ditës së zisë kombëtare në Shqipëri ishte një reflektim i marrëdhënieve të shkëlqyera që ekzistojnë mes dy vendeve tona, në situata të mira dhe të vështira", - u shpreh kolonel Kablay.

Gjeneral brigade Kingji shprehu ngushëllimet më të ndjera për mijëra jetët e humbura dhe pasojat shkatërrimtare të tërmetit të 6 shkurtit, duke u solidarizuar me popullin turk në këtë ngjarje tragjike. "Kjo sfidë na bëri të rikonfirmojmë miqësinë dhe përkushtimin për të mbështetur njëri - tjetrin në situata të tilla. Edhe pse me ndihmë modeste, kemi arritur të kontribuojmë me ekipe të kërkim - shpëtimit gjatë operacioneve në



teren. Ne kurrë nuk mund të harrojmë se çfarë bëri Turqia për ne në rastin e tërmetit të nëntorit 2019 dhe më pas

në ndërtimin e 500 njësive të reja të banimit, pa përmendur mbështetjen dhe ndihmën e gjithanshme ushtarake në

kuadrin e bashkëpunimit tonë ushtarak dypalësh".

Më pas, diskutimi i fokusua në

fushat e tjera të bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve në arsimim, trajnim, stërvitje dhe mbështetjen logjistike.

Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim atasheun ushtarak të Japonisë, kapiten Masashi Abe

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak të Japonisë, jo-rezident, kapiten Masashi Abe.

Gjeneral brigade Kingji u shpreh se: "Vendet tona kanë një marrëveshje bashkëpunimi si në rrafshin ekonomik ashtu dhe atë ushtarak. Ne ndajmë të njëjtat këndvështrime dhe vlera demokratike në mbrojtje të lirisë. Aktualisht, dy vendet tona shërbejnë si vende anëtare jo të përhershme në Këshillin e Sigurisë në OKB. Partneriteti ynë ushtarak është kryesisht nëpërmjet NATO-s, por mendoj që ka ardhur koha të zhvillojmë së bashku bashkëpunimin dypalësh".

Atasheu ushtarak nga ana e tij u shpreh se realizimi i paqes dhe zhvillimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, është i rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë dhe Evropën, por edhe për bashkësinë ndërkombëtare, përfshirë Japoninë.

Japonia ka shfaqur ambicet për të qenë sa më e pranishme në rajonin tonë, ku së fundmi ka emëruar dhe një ambasador për Ballkanin Perëndimor.

Ky takim ishte një mundësi e mirë për të diskutuar nga afër çështje në interes të përbashkët në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.



Realizimi i paqes dhe zhvillimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, është i rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë dhe Evropën, por edhe për bashkësinë ndërkombëtare, përfshirë Japoninë.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji morën pjesë në takim dhe dhjetë të Grupit të Kontaktit për Ukrainën, thirrur nga Sekretari i Mbrojtjes së SHBA, Lloyd J. Austin III.

Takimi u mbajt virtualisht dhe pjesë e tij ishin dhe vendet anëtare dhe partnere të NATO-s.

Ministri Peleshi u shpreh se: Në takim, mes 54 vendeve pjesëmarrës, aleatë dhe partnerë të koalicionit, u vlerësua qëndresa e popullit dhe qeverisë ukrainase, duke mbështetur fort përpjekjet për të mbrojtur territoret e rimarra dhe çlirimin e atyre që janë ende nën pushtimin rus.

Në fund të fjalës së tij ministri Peleshi shprehu solidaritetin e tij dhe shtetit shqiptar ndaj Ukrainës: “Në unitet me partnerët tanë, për të vijuar ndihmën në emër të lirisë dhe të drejtës së jetës në Ukrainë”.

Ukraina ndodhet në luftë që prej 24 shkurtit të kaluar, kur u sulmua nga Rusia. Shqipëria dhe Forcat e Armatosura shqiptare janë rreshtuar në krah të aleatëve në mbështetje të Ukrainës dhe popullit të saj, në këtë luftë të padrejtë dhe të paligjshme të Rusisë ndaj shtetit fqinj dhe sovran.

Ky është takimi i 10-të i Grupit të Kontaktit për Mbështetjen e Ukrainës, që nga krijimi i tij në prill 2022 dhe i treti për vitin 2023.



Takimi i 10-të i Grupit të Kontaktit për Ukrainën

Ministri Peleshi: Në unitet me partnerët tanë, për të vijuar ndihmën në emër të lirisë dhe të drejtës së jetës në Ukrainë



“

Ukraina ndodhet në luftë që prej 24 shkurtit të kaluar, kur u sulmua nga Rusia. Shqipëria dhe Forcat e Armatosura shqiptare janë rreshtuar në krah të aleatëve në mbështetje të Ukrainës dhe popullit të saj, në këtë luftë të padrejtë dhe të paligjshme të Rusisë ndaj shtetit fqinj dhe sovran.

OSFA “ndez” atmosferën në Tiranë

Një ditë ndryshe për Tiranën më 14 mars, Ditën e Verës, festën pagane të cilën shqiptarët e festojnë me madhësi, në nderim të natyrës së bukur shqiptare dhe bimësisë, që merr jetë pikërisht më 14 mars. Dita e Verës, është festë e të gjithë shqiptarëve dhe festohet nga Veriu në Jug. Është dita e fillimit të vitit sipas kalendarit shumë të lashtë të shqiptarëve, pra një ditë që kremtohej shumë shekuj para se të lindte krishterimi. Ajo kremtohej më 1 mars të kalendarit Julian, ditën e parë të vitit të ri (sipas kalendarit Gregorian, 14 mars).

Si asnjëherë tjetër, rrugët e kryeqytetit shqiptar gumëzhinin nga zërat e lumtur të fëmijëve dhe ceremonive të ndryshme festive, organizuar nga Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, e cila kishte mbushur sheshin me ekspozetë e mjeteve ushtarake dhe standat me relikte të historisë së artit ushtarak. Pjesë e këtij aktiviteti ishte dhe Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura. Të veshur me uniformën ceremoniale dhe nën tingujt e veçantë, artistët ushtarakë mbërthyen mijëra kalimtarë, të cilët kishin dalë për të festuar duke vendosur veroret dhe shijuar



balloket, sinonimi i traditës së kësaj feste. Spektatorët më specialë ishin të vegjlit. Disa nga kurioziteti që shihnin vegla muzikore, e disa nga dëshira për t'i dëgjuar, u bënë

“qershia mbi tortë”. Djemtë dhe vajzat e OSFA-së shkëlqyen në interpretimet e tyre, duke i dhënë ngjyra festive kësaj dite të veçantë.

Nga Klaudia Malaj



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në takim atasheun ushtarak turk, kolonel Muhammet Kelami Kablay



Komandën Mbështetëse e vizitoi atasheu ushtarak turk, kolonel Muhammet Kelami Kablay. Ai u prit nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili pas urimit të mirëseardhjes shprehu konsideratat më të larta për popullin turk në përballimin e situatës së vështirë krijuar nga tërmeti i datës 6 shkurt që goditi rajonet jugore të Turqisë. Nga ana e tij, atasheu ushtarak turk, kolonel Muhammet Kelami Kablay shprehu mirënjohjen për kontributin e vyer, dhënë nga ushtria shqiptare me ekipet e kërkim - shpëtimit dhe ato mjekësore në ndihmë të popullsisë goditur nga tërmeti. Ai u shpreh se efektivet shqiptare, në kushte shumë të vështira, arritën të kryenin detyrën e tyre.

Atasheu ushtarak turk shprehu mirënjohje dhe për ndihmat që populli shqiptar ka dërguar në ndihmë të popullit turk, rreth 80 tonë ndihma.

Të dy bashkëbiseduesit u ndalën në marrëdhëniet midis dy ushtrive dhe në rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit në fushën ushtarake. Gjeneral brigade Xhebexhia dhe kolonel Kablay ndanë bindjen se marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe të Turqisë do të intensifikohen edhe më tej në të ardhmen, në përmbushjen dhe arritjen e objektivave të Komandës Mbështetëse.



Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios asgjësojnë minat e paplasura në zonën kufitare të Qafë Prushit

Pas njoftimit nga autoritetet e stacionit kufitar në Qafë Prush të bashkisë Has, për konstatimin e municioneve të rrezikshme, një grup prej 5 vetash specialiste EOD të batalionit të xhenios në KM shkuan në vendngjarje.

Ata në masa të larta sigurie kryen kontroll vizual dhe me aparat minakërkues në një sipërfaqe prej 300 m². Gjatë kontrollit konstatuan tre mina anti-personel të armatosura, prodhim jugosllav, granata dore dhe fishekë luftarak. Minat u asgjësuan me shpërthim pasi sipas manualit ML 400-5-2, minat që konsiderohen të paprekshme e të palëvizshme asgjësohen në vend me shpërthim. Municioni tjetër u transportua dhe u magazinua. Operacioni përfundoi me sukses.

Ky operacion zgjati dy ditë dhe u krye nën mbikëqyrjen e nënkolonel Eduart Ismulli dhe drejtimin e kapiten Roland Hysa. Pas përfundimit me sukses të këtij operacioni ata u përgëzuan nga drejtuesit lokalë dhe ata të stacionit kufitar të Qafë Prushit.



Qendra e Pesonel Rekrutimit organizoi në bashkëpunim me batalionin e tretë të këmbësorisë një ditë të hapur me gjimnazistët e shkollave jo-publike "Irfan Ngjeqari" Berat dhe "Nënshkruesi i Pavarësisë Nebi Sefa" Lushnje. Demonstrime të ndryshme, pjesë nga stërvitjet e batalionit si dhe njohja me armët, ishin disa prej aktiviteteve që shoqëruan të rinjtë. Nuk mungoi as informacioni për të gjithë ata që dëshirojnë të bëhen pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura.

Gjimnazistët shijuan atmosferën e krijuar, të shoqëruar nga një pjesë e mësuesve të tyre.



Zhvillohet Stërvičia II e Përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe asaj spanjolle

Në vetëm një muaj pas përfundimit të Stërvičias së Parë të Përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe spanjolle, në detin Adriatik u zhvillua stërvičia e dytë e përbashkët, ku morën pjesë anijet spanjolle L - 61 "Juan Carlos I", anije shumë-roleshe si zbarkuese dhe aeroplanmbajtësja, fregata F - 82 "Victoria".

Nga Forca Detare mori pjesë anija P - 134 Butrinti si dhe efektivë të Grupit të Bordingut.

Stërvičia u zhvillua në kushte të përkeqësuar të motit me qëllim përgatitjen e efektivave për reagim në situata të vështira.



KLSM-13 viziton Jugun e Shqipërisë

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, në ditën e parë të realizimit të programit "Team Building", zhvilloi një vizitë në Prefekturën e qytetit të Fierit, ku u prit nga Prefekti i qarkut z. Lefter Shehaj, i cili i uroi mirëseardhjen Grupit të KLSM-13, i falënderoi për vizitën dhe i njohu me përgjegjësitë dhe angazhimet e prefekturës, ndryshimet në teknologji dhe bashkëpunimet me Forcat e Armatosura.

Më tej grupi mësimor vizitoi Parkun Kombëtar Arkeologjik të Apolonisë, Fier.

Në sesionin e mbasdites u zhvillua vizitë në Muzeun Kombëtar të Pavarësisë në qytetin e Vlorës.

Në vijim të programit "Team Building" grupi mësimor i KLSM-13 udhëtoi ditën e dytë të vizitës drejt qytetit të Sarandës.

Pjesëmarrësit u pritën në ambientet e Bashkisë Sarandë në një takim të veçantë nga drejtori i kabinetit, i cili i falënderoi me mirënjohje për vizitën dhe i njohu ata me zhvillimin ekonomik të qytetit, të turizmit si dhe bashkëpunimet me Forcat e Armatosura.

Në sesionin e pasdites KLSM-13 vizitoi kalanë e Lëkurësit, duke u njohur me vlerat dhe vendosjen e veçantë të saj.

Pjesëmarrësit e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, kjo vizitë i njohu akoma më shumë me rëndësinë gjeo-strategjike të hapësirës detare të RSH dhe vlerat kulturore të vendit.

Më tej, në vijim të programit në ditën e tretë, KLSM-13 vizitoi Syrën e Kaltër, vend turistik i shpallur monument natyre në fshatin Muzinë të rrethit të Delvinës, ku shijuan luginën piktoreske plot gjelbërim të larmishëm dhe panë nga afër burimin e kaltër me ujë të kristaltë, si burimi më i madh ndër 18 burimet që shpërthejnë nga mali i Gjerë. Në mbasditen e ditës së tretë grupi mësimor u prit nga Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Odise Kote, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit z. Arian Korturi. Në një takim të mirëorganizuar prefekti z. Kote i njohu me shumë pasion dhe vëmendje me historinë, harmoninë fetare dhe komunitare si element të rëndësishëm edhe në ditët e sotme, si dhe me industrinë akomoduese të hotelerisë gjithnjë e në rritje.

Në përfundim të programit treditor pjesëmarrësit e KLSM-13 vizituan kalanë e qytetit, ku mbetën të mahnitur nga historia, objektet, vendosja, trashëgimia kulturore etj.



Kampionati i Futbollit "përball" çunat e FA-së

Pavarësisht shiut e kushteve të motit, fusha sportive e Shtëpisë së Pushimit Durrës, u gjallërua nga djemtë futbollistë të Komandës së Mbështetjes dhe Forcës Detare, më 15 mars 2023. Nje lojë e bukur, e fortë, me sulme, kundërsulme e gola nga të dy palët.

Pavarësisht rezultatit, ku FD fitoi 6 me 5, djemtë e dy ekipeve na dhuruan për 1.5 orë një spektakël të vërtetë.

Ky kampionat ka vlera të gjithanëshme për FA-të, si nga masiviteti, ashtu dhe përgatitja fizike e sportive e dhjetra ushtarakëve tanë për këtë sport të dashur e burrëror.

Në fund të kampionatit do përzgjidhen 3 ekipet më të mira, të cilët do përfaqësojnë FA-të në takimet e kompeticionet me ekipet që do caktojë Federata Shqiptare e Futbollit. Kjo është një fushë tjetër e bashkëpunimit civilo-ushtarak e Forcave tona të Armatosura me institucionet e komunitetin civil. Suksese djemve me uniformë!



HISTORI SUKSESI

Kur flasin rezultatet

Nder dhe krenari për Forcën Detare

Nënoficeri i Forcës Detare, Eugen Egro, nderoi veten dhe Forcën Detare, në seminarin e zhvilluar me specialistet e gardës së New Jersey-t dhe me pjesëmarrjen e trupës së nënoficerëve me grada të larta në Forcat tona të Armatosura.

Në përfundim të këtij seminary, ku u trajtuan çështje që kanë të bëjnë me formimin ushtarak e profesional të gradës "kapter" e "k/kapter",

Kapter Eugen Egro u vlerësua nga ekipi amerikan me pikë maksimale dhe zuri vend të parë për performancën më të mirë në rang FA.

Kapter Egro, ka kryer detyra të rëndësishme në FA dhe në Forcën Detare. Ai kudo është shquar për disiplinë, korrektësi, profesionalizëm e devotshmëri.

Në misionet e kryera në Irak e Afganistan, ai ka qenë pjesë e grupit të sigurisë së gjeneral David Petraues, që ishte Komandant i Forcave Aleate në këto misione.

Eugeni ka marrë vlerësime



Nëderkohë krahas arsimimit e trajnimit në fushën ushtarake, Eugeni, mban dhe diplomën e Fakultetit Juridik, që e bën atë një nënoficer të kompletuar, të gatshëm të kryejë çdo detyrë në Forcat tona të Armatosura.

Ai angazhohet dhe në sporte të ndryshme, ku bazë është noti, ku është shpa-llur dhe kampion në disa gara me ekipin "Teuta". Rezultatet flasin vetë. Me këto arritje, Geni nderon veten, familjen, Forcën Detare dhe FA.

Shefqet Kërçelli

maksimale nga Gjenerali, i cili është mik i shqiptarëve dhe ka mirëpritur mjaft shqiptare. Por, zanafillën kjo miqësi e ky respekt për shqiptarët, e ka tek djem si Eugen Egro, e të tjerë si ai.

INTERVISTË ME MËSUESEN ZAMIRA DEDEJ

Mirënjohje pafund për pishtarët e palodhur të dijes

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në radhën e gjeneratës së mrekullueshme të mësuesve të shkollës “Skënderbej”, bën pjesë mësuese Zamira Dedej, një prej atyre që lanë gjurmë të rëndësishme në edukimin dhe mësimin e skënderbegasve të disa brezave. Si mësuese, ajo gjendej gjithnjë pranë nxënësve për të ndihmuar ata që hasnin vështirësi e për të mundësuar asimilimin më të lehtë të lëndës.

Mësuese Zamira është ndër mësueset e përzgjedhura që afrohet për të dhënë mësim në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Në këtë periudhë, kjo shkollë ishte konsoliduar me kuadro mësimdhënës e oficerë komandues nga më të mirët dhe kishte shtuar ndjeshëm numrin e nxënësve që studionin në të.

Pjesë e këtij kolektivi mësimdhënësish e komanduesish, bëhet dhe Zamira. Janë shumë breza skënderbegasish të këtyre viteve, që ruajnë respektin më të madh për mësuesen e tyre Zamirën. Ata kujtojnë pasionin e saj për orën e mësimin, gatishmërinë për t’i ndihmuar në kohën e lirë, përpjekjet e saj për të evidentuar e përkrahur talente, të cilët shkëlqyen në rrugëtimin e tyre.

Mësuese Zamira Dedej vjen për lexuesin tonë nëpërmjet kujtimeve 40-vjeçare të saj, mes nxënësish që për të ishin dhe bij.

Kur keni filluar punën në arsim dhe si ju ka ngelur në kujtesë ajo kohë, dita e parë kur keni marrë

“

Mësuese Zamira është ndër mësueset e përzgjedhura që afrohet për të dhënë mësim në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Në këtë periudhë, kjo shkollë ishte konsoliduar me kuadro mësimdhënës e oficerë komandues nga më të mirët dhe kishte shtuar ndjeshëm numrin e nxënësve që studionin në të.

ditarin në dorë, ditë që nuk harrohet kurrë?

Vitet që unë kam dhënë mësim në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake, zënë një vend të rëndësishëm në karrierën time si mësuese për shumë dekada në Tiranë. E theksoj që në fillim se kam qenë me fat që m’u dha mundësia të punoj në këtë shkollë bashkë me kolegë të përgatitur e të nderuar dhe në një institucion elitare,



dhe ajo që është më e rëndësishmja, në marrjen e rendimentit maksimal në përfitimin e dijeve.

Regjistrin për herë të parë e kam hapur shumë kohë më parë se të filloja të ushtraja profesionin e mësimdhënies në shkollën “Skënderbej”. Sepse fillimisht kam punuar si mësuese në një shkollë civile, por të them të vërtetën emocionet që kam marrë prej skënderbegasve janë të veçanta.

dhe ajo që është më e rëndësishmja, në marrjen e rendimentit maksimal në përfitimin e dijeve.

Regjistrin për herë të parë e kam hapur shumë kohë më parë se të filloja të ushtraja profesionin e mësimdhënies në shkollën “Skënderbej”. Sepse fillimisht kam punuar si mësuese në një shkollë civile, por të them të vërtetën emocionet që kam marrë prej skënderbegasve janë të veçanta.

Cilat kanë qenë kushtet dhe vështirësitë, me të cilat jeni përballur në vitet e para në shkollën “Skënderbej”?

Shkolla “Skënderbej” ishte shkollë elitare dhe kabinetet ku punonim ishin mjaft të mira, me kapacitete të plota të materialeve për zhvillimin e lëndës.

Ne ndiheshim komodë në punën tonë, dhe kjo na ndihmonte për të qenë produktiv dhe me rezultate të shkël-



Ne ndiheshim komodë në punën tonë, dhe kjo na ndihmonte për të qenë produktiv dhe me rezultate të shkëlqyera. Programi i shkollës “Skënderbej” ishte i njëjtë me atë të shkollave civile, por me bindje them që nxënësit që dilnin nga ajo shkollë ishin ekselentë.

qyera. Programi i shkollës “Skënderbej” ishte i njëjtë me atë të shkollave civile, por me bindje them që nxënësit që dilnin nga ajo shkollë ishin ekselentë.

Si ishin ditët e para të punës?

U ndjeva mjaft mirë, ata ishin fëmijë sistematik, me norma qytetare dhe ta bënin të lehtë punën.

Si i kujtoni nxënësit tuaj të parë?

Shumica e tyre vinin nga rrethet, pra ishin larg familjes së tyre dhe disa prej tyre ende se kishin gjetur veten në një mjedis si shkolla “Skënderbej”, ku rregulli dhe disiplina ishte e pamundur të shkeleshin. Nganjëherë të dukeshin si trumcakë të trembur, të cilët kishin shumë nevojë për një fjalë të ngrohtë dhe për më tepër një fjalë nëne, këtë kisha unë parasysh kur hyja në klasë. Pasi shkëmbeu buzëqeshje me njëritjetrin dhe teksa i pyesja se si ndiheshin çdo ditë, fillonim mësimin, i cili për ta ishte në respekt të plotë.

Ju jeni një mësuese me një eksperiencë të gjatë pune, mësuese prej 40 vjetësh, çfarë mund të na thoni sot për këtë rrugëtim të gjatë në shërbim të dijës dhe për më tepër, në një institucion ushtarak?

Kushdo që ka qenë mësime të mësuara në shkollën “Skënderbej” ka përfutur jo pak në profesionin e tij. Kjo për faktin se për shkak të shumë paraleleve (klasave), të njëjtin mësim dite, do e jepje deri në 5-6 herë në ditë. Kështu që, natyrshëm, nguliteshin detaje anësore e përsosje mësime të mësuara. Për shkak të kujdesit shtetëror e punës së trupës pedagogjike e komanduese, niveli i dijeve ishte në kuota më të mira. Njëkohësisht, për shkak të përzgjedhjes së nxënësve që vinin, si fizikisht ashtu dhe nga niveli i dijeve, falë kushteve të mira teknike e materiale, shkolla ishte si një laborator shumëplanësh, ku zbulohesh, zhvillohesh e rritej talenti i shumë skënderbagasve në fusha të ndryshme.

Pse keni zgjedhur këtë profesion?

Unë në rininë time të hershme dëshirova më të madhe e kisha të bëhesha mjek, por, siç dihet, në ato vite ishte e vështirë të realizoje ëndrrat e tua.

Por megjithatë, pas kaq vitesh unë them se profesionin e mësuesit nuk do ta ndërroja me asgjë tjetër.

Ju përveçse keni qenë mësuese, në të njëjtën kohë keni bërë edhe rolin e bashkeshortës dhe të nënës. A ka qenë e vështirë për ju që t'i bënit të tria këto role?

Unë jam nënë e dy vajzave, disa herë gjyshe, jam me fat dhe ndihem e realizuar në detyrën time si prind. Pa mbështetjen e bashkeshortit tim, i cili prej vitesh nuk është mes nesh, por që

tek ne ka lënë vragë, si bashkudhëtar i jetës sime, baba dhe gjysh. Me krijimin e lehtësirave në familje nga bashkeshorti dhe vajzat e mija do ta kisha të vështirë të ecja përpara.

A mund të na sillni disa kujtime që ju keni përjetuar gjatë kësaj periudhe të gjatë si mësime të mësuara?

Unë kam plot kujtime, sepse rrugëtimi i gjatë patjetër sjell kujtime dhe mall.

Një prej tyre është një prej nxënësve të mi, i cili kishte prirje për tjetër fushë dhe donte të largohej nga shkolla, kërkonte me insistim të ngelej në provimet e fund-vitit, sepse vetëm kështu mund të realizonte ëndrrën e tij. Por unë në provimin e bërë në lëndën time, nuk e kisha ngelur. Ai së bashku me gjithë klasën vijonë më takojnë për të më kërkuar si ‘nder’ që ta ngelja.

U ndjeva ngushtë dhe me zërin e plogësht që më karakterizon i thashë: “Po unë gjatë gjithë karrierës time si mësuese nuk kam ngelur kurrë nxënës.”

Ata më rrethuan dhe me sytë gjithë dashuri më vështronin sikur donin të thoshin: Faleminderit mësuese!

A ju takojnë sot ish-nxënësit tuaj?

Ndihem shumë mirë kur më ndalojnë në rrugë dhe më përshëndesin, nuk i mbaj mend të gjithë, por lumturohem kur më thonë “mësuese jemi ‘Skënderbegas’”.

Gjatë bisedës tonë me mësuese Zamirën rastësisht gjendemi mes një grupi “skënderbegasish”, ish-nxënës të saj, të cilët me shumë dashuri na dhanë opinionin e tyre për mësuesen e dashur.

Sot ata janë njerëz të suksesshëm në fusha të ndryshme të jetës si Leonard Musollari, ushtarak karriere, i cili me shumë mirënjohje falënderon mësuese Zamirën: “Faleminderit shumë mësuesja jonë, për dashurinë dhe kujdesin tuaj, faleminderit për dhuratën e gëzimit dhe vëmendjes, për respektin dhe mirëkuptimin, për ngrohtësinë e zemrës dhe njohuritë e qëndrueshme, për këshillat e mira dhe kohën e lirë emocionuese. Faleminderit për punën tuaj të paçmuar dhe të guximshme, për qasjen tuaj individuale, për qëndrimin dhe mirëkuptimin tuaj, për përpjekjet tuaja dhe mësimet emocionuese”.

Ish-skënderbegasi, sot biznesmen i suksesshëm, Julian Ballabani për mësuesen e tij do të shprehte dy fjalë zemre: “Për botën ti je thjesht një mësuese, por për ne nxënësit e tu je një heroinë. Jo të gjithë e kanë shansin të gjejnë dhe të takojnë mësuesen “ideale”, por ata fatlumë që e gjejnë këtë person, janë të bekuar. Unë jam një nga ata njerëz me fat që e kam takuar



mësuesen time ideale, zonjën me flokët e arta që sot madhësisht qëndron stoike përpos moshës dhe sfidave të jetës. Faleminderit për gjithë dashurinë tënde e dashur mësuese Zamira!

Z. Arben Prasta, avokat, i cili për mësuesen ruan konsideratë të mëdha: “Emocion i veçantë pas kaq kohësh të takohesh me mësuesit e tu, me mësuesen Zamira Dede! Kujtoj qetësinë e këmbënguljen e saj për mësim nxënien në mësime të mësuara. Mësuese Zamira kishte krijuar në kabinetin e saj oaz paqeje me ngrohtësi, qetësi e dashuri për nxënësit e saj ushtarakë dhe bënte diferencë shumë të madhe, jo vetëm me vrazhdësinë që kishte ambienti ushtarak në një shkollë të mesme, por edhe me kolegë të saj. Konsideratat pa fund për njerëzoren për kapacitetet e larta intelektuale dhe dashurinë në ushtrimin e detyrës së saj në mësime të mësuara e arritje! Vlerësim i lartë ishte nga kushdo dhe në breza dhe zor se do të hiqet në memorien tonë si

nxënës të saj dhe të gjithë brezave të studentëve të saj!”

Ylli Shena, ish-skënderbegas, sot në fushën e biznesit për mësuese Zamirën do të shprehej: “Zamira ishte dashuri... Ne që ishim në ambient ushtarak, ku ishim të privuar nga shumë liri të tjera të bashkëmohatarëve tanë, mësuese Zamira me butësinë e saj dhe aromën e një nëne na lehtësonte ‘dhimbjen’... Kur doli në pension, u ndamë me dhimbje”.

Çfarë do iu thoshit sot ish-nxënësve tuaj, të cilët ruajnë konsideratë të mëdha për ju?

Uroj me gjithë shpirt, të gjithë skënderbegasit kudo që janë, të kenë gëzime, lumturi dhe begati në familjet e tyre.

Në mënyrë të veçantë uroj të gjitha bashkeshortet e skënderbegasve dhe u kujtoj fatin e tyre të mirë që kanë marrë për bashkeshortë skënderbegasit, ndër njerëzit më të mirë, më të dashur dhe më të ndershëm të popullit

shqiptar. I kujtoj me mall dhe me nostalgji vitet që kam kaluar në shkollën “Skënderbej”. Këto vite, të kaluara mes rinisë më të bukur të kombit, më kanë rinuar edhe mua shpirtin dhe më mbajnë ende gjallë me kujtimet më të mira të atyre viteve. Mbase në punën time kam bërë edhe padrejtësi, mbase ndonjëherë i kam gjykuar ndryshe ngjarjet dhe fenomenet, por asnjëherë nuk kam pasur në shpirtin tim keqdashje dhe qëllime jo të mira. Gjithmonë kam pasur parasysh që skënderbegasit të edukoheshin mirë dhe të formonin një karakter të fortë për t’u përballuar me dinjitet me vështirësitë e profesionit. Nuk e di se sa ia kam arritur, por fjalët dhe komentet tuaja kur më takoni më tregojnë se kam bërë diçka të mirë, aq sa kam lënë gjurmë në personalitetin tuaj.

Ju falënderoj nga zemra për fjalët e mira dhe dëgjofshatë vetëm të mira për ju, skënderbegasit e mi!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

E kaluara rrënjë e trungut, e tashmja fruti, e ardhmja fara

Në shumë njerëz realiteti i gjërave është aktualiteti i tyre, gjërat janë ashtu sikurse i shohim në një moment të caktuar. Në përgjithësi njerëzit prirën të besojnë tek njohja e tyre për aktualitetin, për atë që ndodh përpara syve të tyre dhe ajo që e përjetojnë vetë është maksimumi i njohjes së tij. Kjo bindje shprehet në mënyra të ndryshme, por kryesisht në idenë se e kaluara nuk na intereson shumë, se ka kaluar tashmë, kurse e ardhmja, po ashtu nuk mund të parashihet dhe as të jetohej me ankthin e saj.

Shpesh pyes veten mbi të kaluarën e prindërve tanë, por dhe timen gjithashtu, për atë pjesë utopike të fëmijëve tanë sot.

Si ia dolën të mbijetonin me ushqim që përmbante laktozë?

Si ishim ne, në gjendje të rriteshim pa homogjenizues, shtesa ushqimore, hormone dhe multivitamina!?

Si kemi jetuar pa Cola-cola zero, Red Bull, aperitivë dhe long drinks, nëse prisnim të dielën për të pirë ujë të gazuar me pluhura të tretura?

Si i kalonim dimrat e ashpër me bukë, vaj e kripë, pa Nutella!?

Sa të kënaqur ishim me ushqimin e pasdites, bërë nga buka, gjalpi dhe sheqeri, i racionuar, pa përdorur shtrydhëset e frutave dhe perimeve?

Si i kalonim mbrëmjet e verës me një thellë shalqi në rrugë!

Si e duronim dënimin e një profesori, dhe e përqafonim kur e takonim pas shumë vitesh!? Sot profesorët stepen para nxënësve.

Si kemi bërë që jemi dashuruar me shokun e klasës, pa një fizik si bodybuilder?

Si kemi mundur të bënim pa trajnerin personal, pasi luanim vetëm volejball, futboll në terrene të baltosura, me një top të blerë vullnetarisht nga të gjithë dhe e ruanim si gjë të shtrenjtë, ndërsa më i pafati ishte gjyqtar?

Si mbijetuam me gjunjët e bërë copë dhe të dezinfektuar vetëm me pështymë, pa përdorur antibiotikë antiseptikë dhe mjekime?

Si takoheshim me njeriun e zemrës, kur nuk kishte celular dhe SMS-të e vetme ishin një shënim në ditar dhe një puthje me rrezik?

Si mundeshim të shkruanim poezi dhe kompozonim kënge pa përdorur një kompjuter dhe ku çdo notë muzikore apo varg poetik kishte një mesazh dhe trupin ta përshkruanin drithërima ndjesore, që edhe sot



ruajnë të njëjtën vlerë.

Si ia dilnim xhanëm, të prisnim për një kohë të pafund për të dhënë puthjen e parë!?

Kjo e kaluara jonë dhe e prindërve tanë që u përpoqën të na mësonin të mos kishim frikë për të ardhmen, nëse të tashmen do e



E KALUARA ËSHTË E RËNDËSISHME PËR TË NA TREGUAR GABIMET DHE VENDIMET TONA TË MIRA. TË MENDUARIT PËR TË KALUARËN ËSHTË THELBËSORE PËR TË KUPTUAR TË TASHMEN. RRUGA JONË NË JETË DUHET TË KETË NJË KUPTIM DHE NE DUHET TË DIMË SE NGA KEMI ARDHUR PËR TË DITUR SE KU PO SHKOJMË.

jetonim me këmbët mbi tokë.

Nuk rrinim zgjuar deri në mëngjes por dinim të ëndërronim për të ardhmen, të cilën nuk humbnim kohë për ta projektuar.

Realja dhe aktualja nuk janë e njëjta gjë

Ajo që ndodh është shumë herë më e gjerë se sa ajo që shohim dhe dimë. Çka ndodh nuk është se na shfaqet menjëherë dhe na vihet në dispozicion, përderisa nuk mund ta dimë realitetin e asaj që na ndodh, thjesht “nuk ia vlen të thellohem i e stresohemi dhe le të ndodhë ajo që do të ndodhë”.

Kjo, në fakt do të thotë të dorëzohemi dhe ta shohim të pashpresë veten përballë njohjes.

A jemi të pashpresë dhe a duhet të dorëzohemi përballë njohjes?

Gjithçka varet nga ajo që duam ose nuk duam të dimë, dhe kjo duhet të përcaktohet nga ajo që na duhet ose duhet të dimë ose nga raporti mes njohjes që duam dhe asaj që na duhet neve.

Koha është aq kalimtare sa rreshti që sapo mbaruat së lexuari tashmë është bërë e kaluara dhe e ardhmja, të gjitha mendimet që keni për atë që do të vijë më pas, janë para jush.

E kaluara është ajo që ka mbetur

E kaluara është e rëndësishme për të na treguar gabimet dhe vendimet tona të mira. Të menduarit për të kaluarën është thelbësore për të kuptuar të tashmen. Rruga jonë në jetë duhet të ketë një kuptim dhe ne duhet të dimë



GJITHÇKA VARET NGA AJO QË DUAM OSE NUK DUAM TË DIMË, DHE KJO DUHET TË PËRCAKTOHET NGA AJO QË NA DUHET OSE DUHET TË DIMË OSE NGA RAPORTI MES NJOHJES QË DUAM DHE ASAJ QË NA DUHET NEVE.

se nga kemi ardhur për të ditur se ku po shkojmë.

E ardhmja jonë gjithashtu duhet të ketë kuptim dhe duhet të dimë qartë se cilat janë objektivat tona. Është gjithashtu e rëndësishme të jesh në gjendje të veprësh në të tashmen.

Rruga që marrim përbëhet nga hapa të vegjël drejt fatit tonë.

Kjo na stimulon të jemi të qëndrueshëm dhe këmbëngulës në procesin e arritjes së diçkaje që do të na sjellë dobi në të ardhmen.

Megjithatë, e ardhmja është gjithashtu një thikë me dy tehe. Ka shumë gjëra në jetë që nuk jemi në gjendje t'i kontrollojmë.

E ardhmja mund të shihet si pyetje, e kaluara mund të shihet si shënim dhe e tashmja mund të shihet si përgjigje.

E ardhmja është pyetja sepse nuk e dimë se çfarë do të ndodhë. Frika për të ardhmen është për shkak të kësaj pasigurie.

E kaluara ka ndodhur tashmë, kështu që tashmë e dimë se çfarë ka ndodhur. Duke parë të kaluarën, rishikojmë shënimet në mënyrë që të japim përgjigje...

E tashmja është përgjigja sepse është rezultati përfundimtar. Ajo që po ndodh tani është rezultat i pyetjeve të udhëhequra nga e kaluara.

TAKIM VIRTUAL I GRUPIT TË KONTAKTIT TË MBROJTJES SË UKRAINËS

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

NATO do t'i ofrojë me shpejtësi Ukrainës aftësitë kryesore

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori pjesë në takim virtual të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës, të kryesuar nga Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-ve, Lloyd J. Austin III dhe Kryetari i Shefave të Përbashkët të Shtabit, gjeneral Mark Milley, (15 mars 2023). Diskutimi u fokusua në rëndësinë e mbështetjes, si dhe rritjes së mbështetjes për Ukrainën, ndërsa vendi vazhdon t'i rezistojë luftës brutale të agresionit të Rusisë.

Sekretari i Përgjithshëm e përditësoi grupin mbi përpjekjet e NATO-s dhe aleatëve për t'i ofruar Ukrainës me shpejtësi aftësitë kryesore, duke përfshirë më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore, më shumë armaturë dhe më shumë municione. Z. Stoltenberg theksoi se puna e vazhdueshme për të rritur bazën industriale të mbrojtjes së NATO-s është thelbësore për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen aleate, si dhe për të ofruar mbështetje për Ukrainën për aq kohë sa është e nevojshme.

Takimi i 10-të i Grupit të

Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës

Takimi virtual i 15 marsit, i drejtuar nga Sekretari i Mbrojtjes Lloyd J. Austin është takimi i dhjetë i Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës, (UDCG), që nga formimi i grupit ndërkombëtar në prill. Takimit iu bashkuan edhe ministrat e Mbrojtjes dhe shefat e Mbrojtjes nga gati 50 vende nga të gjithë bota për të diskutuar luftën e vazhdueshme të Rusisë në Ukrainë dhe koordinimin e vazhdueshëm të ngushtë për t'i siguruar popullit ukrainas mjetet e nevojshme për të mbrojtur territorin e tyre sovran. "Për takimin tonë virtual sot, ne kemi anëtarë të Grupit të Kontaktit që bashkohen nga e gjithë bota dhe nga shumica e zonave, duke përfshirë miqtë në Amerikë, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Indo-Paqësor. Sot, ne po mblidhemi për t'u siguruar që do të vazhdojmë të përbushim premtimet tona për të mbështetur mbrojtjen e Ukrainës", - tha Sekretari i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III.

"Më shumë se një vit më parë, Rusia filloi pushtimin e saj të paligjshëm dhe të paprovokuar në shkallë të plotë dhe që atëherë, forcat e Ukrainës kanë luftuar me guxim për të mbrojtur sovranitetin, territorin dhe lirinë e tyre. Asnjë ukrainas nuk duhet të durojë granatimet e përditshme. Asnjë prind ukrainas nuk duhet të shqetësohet se shkolla e fëmijës së tyre do të bombardohet. Asnjë komb nuk duhet të luftojë për mbijetesën e tij kundër një force pushtuese të huaj që po rrafshon qytetet dhe qyteza të tëra. Vendet këtu sot e kuptojnë rrezikun e luftës së zgjedhur të Rusisë, si për popullin ukrainas ashtu edhe për botën. Ky është kërcënim i madh për sigurinë evropiane që nga fillimi i Luftës së Ftohtë, pas Luftës së Dytë Botërore. Është një sulm i drejtpërdrejtë ndaj rëndit ndërkombëtar të bazuar në rregulla që na mban të gjithëve të mbrojtur dhe të sigurt", - theksoi sekretari i Mbrojtjes amerikane. Gjatë vitit të kaluar, Forcat e Armatosura të Ukrainës kanë arritur disa fitore goditëse në fushën e betejës, të gjitha këto duke e formuar me shpejtësi ushtrinë e Ukrainës në një forcë të fortë dhe profesionale. Lloyd J. Austin III falënderoi, ministrin e Mbrojtjes, Olexii Reznikov, pjesëmarrës në takim, për udhëheqjen e tij të Forcave të Armatosura të Ukrainës. "Grupi i Kontaktit ka qenë gjithmonë i përkushtuar për të ndihmuar Forcat e Armatosura të Ukrainës të marrin atë që u nevojitet, kur u nevojitet".

Në fillim të këtij muaji, Shtetet e Bashkuara njoftuan një ndihmë tjetër prej 400 milionë dollarësh për Ukrainën, për sigurinë, për të mbështetur operacionet e zjarrit preciz, artilerisë dhe automjeteve të blinduara. Kjo përfshin municion shtesë HIMARS, raunde shtesë artilerie, ura të lëshuara me automjete të blinduara, etj. "...Ndërsa dërgojmë më



shumë pajisje në Ukrainë, ne mbetemi të përqendruar në llogaridhënie, së bashku me partnerët tanë ukrainas".

Vetëm në tre muajt e fundit, anëtarët e këtij Grupi të Kontaktit kanë treguar lidhshmëri të madhë në ndërtimin e aftësive që i duhen Ukrainës për të mbrojtur sovranitetin e saj dhe për të krijuar vull në fushën e betejës, përfshirë më shumë se nëntë brigada automjetesh të blinduara. Koalicioni i vendeve që po dhurojnë tanke "Leopard" në Ukrainë vazhdon të rritet dhe nëntë vende tani janë zotuar të ofrojnë më shumë se 150 tanke "Leopard". Përballë fushatës mizore të bombardimeve të Rusisë, numri i vendeve që ofrojnë mjete të mbrojtjes ajrore gjithashtu vazhdon të zgjerohet. Për shembull, në Grupin e fundit të Kontaktit, u tha për kontributin SAMP/T të Italisë dhe Francës.

Shtetet e Bashkuara, Gjermania dhe Holanda kanë dalë me donacione, siç janë raketat Patriot dhe shumë vende të tjera, kanë ofruar mbrojtje ajrore me rreze më të shkurtër veprimi. Kanadaja dhe Gjermania kanë kontribuar me sisteme të mbrojtjes ajrore me rreze të mesme si NASAMS dhe IRIS-T. "Por tani jemi në një moment vendimtar në rrjedhën e luftës së Ukrainës për liri dhe ne të gjithë duhet të demonstrojmë vendosmërinë dhe unitetin tonë të vazhdueshëm. Kjo do të thotë të zbatojmë angazhimet tona, plotësisht dhe shpejt. Ne duhet t'i ofrojmë Ukrainës aftësitë e plota për luftën përpara, përfshirë pjesët e këmbimit dhe paketat e mirëmbajtjes për të mbështetur aftësitë kritike të ofruara nga anëtarët e Grupit të Kontaktit, si dhe pajisje shtesë. Gjithashtu grupi duhet të gjejë mënyra për të marrë donacione të reja të municioneve dhe sistemeve të mbrojtjes ajrore në Ukrainë. Për të rritur prodhimin e municioneve, anëtarët e Grupit të Kontaktit po bashkohen për të zhvilluar zgjidhje novatore për problemet e prodhimit industrial, për të përbushur nevojat e Ukrainës në pranverë dhe më tej.

Prillin e kaluar, ndërsa Grupi i Kontaktit filloi me një takim të vetëm, mbledhur nga ekipet më të shquara aleate, ai tashmë është rritur në një bashkësi veprimi plotësisht të përkushtuar dhe me bindje se do të mbështesë mbrojtjen e Ukrainës për një kohë të gjatë.

Në muajt e fundit, Kremli ka demonstruar vazhdimisht se nuk i kushton vëmendje jetës së forcave të veta dhe se ka intensifikuar luftën e tij të pamatur pushtuese. Rusia vazhdon të regjistrojë kompani private mercenare si

"Wagner Group" dhe të çojë në vdekje rekrutët e papërvojë. Por forcat tokësore të Ukrainës i kanë shtyrë forcat ruse me armët dhe tanket e dhuruara nga vendet e UDCG dhe Rusia vazhdon të dërgojë valë pas valë raketa lundrimi dhe dronë vetëvrasës iranianë për të terrorizuar qytetet dhe civilët ukrainas. Por sistemet e mbrojtjes ajrore të Ukrainës, nga ana tjetër, shumë prej të cilave grupi UDCG u ka siguruar, po luftojnë për të mbajtur civilët të sigurt nga bombardimet e Rusisë.

Kjo është historia e këtij Grupi të Kontaktit dhe unë jam i bindur se ne do të vazhdojmë të rritemi. Jam i bindur se do të përbushim angazhimet tona", -tha sekretari i Mbrojtjes amerikane, Austin. "Pas 10 takimeve të Grupit të Kontaktit, uniteti ynë i përpjekjeve vazhdon të jetë një burim i fuqishëm fuqie. Ne do të mbetemi të vendosur dhe të bashkuar në mbështetje të së drejtës së Ukrainës për të jetuar si një vend i lirë dhe sovran, për aq kohë sa të duhet."

Rritje urgjente e mbështetjes ushtarake për Ukrainën

Takimi i Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës të udhëhequr nga SHBA-të për vitin 2023 u thirr për herë të parë në Ramstein, Gjermania më 20 janar. Takimi u kryesua nga Sekretari Amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, dhe filloi me një video-fjalim nga Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy.

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg tha në atë takim se Rusia nuk po tregon asnjë shenjë se po përgatitet për paqe, por përkundrazi, po përgatitet për një luftë të gjatë. Prandaj, theksoi atje Sekretari i Përgjithshëm, është urgjente të rritet më tej mbështetja ushtarake, në mënyrë që Ukraina të fitojë dhe të çlirojë territorin e pushtuar. "Ashtu si shumica e luftërave, kjo ka të ngjarë të përfundojë në tryezën e negociatave, - tha Stoltenberg, - por ajo që ndodh në negociatë është e lidhur drejtpërdrejt me atë që ndodh në fushën e betejës, kështu që ne duhet t'i dërgojmë më shumë armë Ukrainës tani". Stoltenberg falënderoi në atë takim Sekretarin e Mbrojtjes Lloyd Austin, për udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara në ofrimin e ndihmës shumë të rëndësishme ushtarake për Ukrainën. Ai mirëpriti njoftimet e fundit të bëra nga aleatët dhe partnerët e tjerë të NATO-s, përfshirë Gjermaninë, Francën, Kanadanë, Danimarkën, Holandën dhe Suedinë në lidhje me mbrojtjen ajrore, mjetet luftarake të këmbësorisë dhe mjetet e blinduara. Nga ana tjetër edhe Britania

e Madhe, Franca dhe Polonia kanë qenë të gatshme të dorëzojnë tanke kryesore luftarake dhe tanke të lehta. Sekretari i Përgjithshëm bëri thirrje gjithashtu për furnizime të vazhdueshme me municion, pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje, si dhe trajnime. Në përgjithësi, ai theksoi se vendet e Grupit të Kontaktit po ofrojnë "një paketë masive të aftësive luftarake" për vetëmbrojtje të Ukrainës. Si në vitin 2022 edhe në fillim të vitit 2023, Sekretari i Përgjithshëm ka nënvizuar rëndësinë e rritjes së ndihmës ushtarake jo-vdekjeprurëse, duke vënë në dukje se Paketa Gjithëpërfshirëse e Ndihmës së NATO-s, po siguron karburant, ushqim, dhe furnizime mjekësore më shumë për Ukrainën. Por ndërkohë aleatët e NATO-s duhet të rrisin prodhimin e armëve dhe municioneve dhe të rimbushin me shpejtësi rezervat dhe për këtë Aleanca po punon ngushtë me industrinë, ku prokurimi është një temë kryesore, për këtë qëllim.

Takimi tjetër u mbajt, më 14 shkurt 2023, në Bruksel në selinë e NATO-s, ku edhe këtu Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg falënderoi Sekretarin e Mbrojtjes Lloyd Austin për angazhimin e fortë ndaj lidhjes dhe marrëdhënieve transatlantike, ndaj NATO-s dhe për lidhshmërinë amerikane të jashtëzakonshme në ofrimin e mbështetjes për Ukrainën, udhëheqjen e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës dhe gjithçka që Shtetet e Bashkuara kanë bërë për të siguruar që Ukraina të marrë armët, furnizimet që i nevojiten për të fituar luftën dhe për të çliuar territorin e saj.

"Sfidat me të cilat përballet Aleanca janë të mëdha dhe të gjithanshme dhe kjo është një kohë historike për sa i përket sigurisë së Europës dhe Europa është e përfshirë në gjithçka ndodh përreth saj, në këtë krizë të Ukrainës. Ukrainasit kanë bërë vërtet jashtëzakonisht mirë disa prej gjërave, bazuar në atë që aleatët dhe partnerët po bëjnë për të ofruar ndihmë për sigurinë, për sa i përket NATO-s, kurrë më parë nuk ka qenë kaq të bashkuar, përkundër faktit se gjatë gjithë vitit ajo është përbërur me një sërë sfidash".

NATO ka ofruar nivel të paprecedentë mbështetjeje për Ukrainën

Një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për stabilitetin e zonës euroatlantike. Marrëdhëniet midis NATO-s dhe Ukrainës datojnë në fillim të viteve 1990 dhe që atëherë ato janë zhvilluar në një nga partneritetet më thelbësore të

NATO-s. Që nga viti 2014, në vazhdimësi e aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, bashkëpunimi është intensifikuar në fusha kritike. Që nga pushtimi i plotë i Rusisë në vitin 2022, NATO dhe aleatët kanë ofruar nivele të paprecedentë mbështetjeje.

Dialogu dhe bashkëpunimi filluan kur Ukraina e sapo shpallur e pavarur iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (1991) dhe programit të Partneritetit për Paqe (1994). Marrëdhëniet u forcuan me nënshkrimin e Kartës së 1997 mbi një Partneritet të Veçantë, i cili themeloi Komisionin NATO-Ukrainë (NUC) për të çuar përpara bashkëpunimin. Që nga viti 2009, NUC ka mbikëqyrur procesin e integritetit euroatlantik të Ukrainës, përfshirë reformat në kuadër të Programit Kombëtar Vjetor (ANP). Bashkëpunimi është thelluar me kalimin e kohës dhe është reciprokisht i dobishëm, me Ukrainën që kontribuon në mënyrë aktive në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO. Përparsi i jepet mbështetjes për reformën gjithëpërfshirëse në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes, e cila është jetike për zhvillimin demokratik të Ukrainës dhe për forcimin e aftësisë së saj për të mbrojtur veten.

Që nga Samiti i NATO-s në Varshavë në korrik 2016, mbështetja praktike e NATO-s për Ukrainën është përcaktuar në Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndihmës (CAP) për Ukrainën. Në qershor 2017, Parlamenti ukrainas miratoi legjislacionin që rivendos anëtarësimin në NATO si një objektiv strategjik të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në vitin 2019, një amendament përkatës i Kushtetutës së Ukrainës hyri në fuqi. Në shtator të vitit 2020, Presidenti Volodymyr Zelenskyy miratoi Strategjinë e re të Sigurisë Kombëtare të Ukrainës, e cila parashikon zhvillimin e partneritetit të veçantë me NATO-n me qëllim anëtarësimin në NATO. Në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, që nga viti 2014 NATO ka përforcuar mbështetjen e saj për zhvillimin e aftësive dhe ndërtimin e kapaciteteve në Ukrainë. Aleatët dënojnë dhe nuk do të njohin aneksimin e paligjshëm dhe të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe aktivitetet e saj destabilizuese dhe agresive në Ukrainën lindore dhe rajonin e Detit të Zi. NATO ka rritur praninë e saj në Detin e Zi dhe ka rritur bashkëpunimin detar me Ukrainën dhe Gjeorgjinë.

NATO dënon luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës në termat më të ashpër të mundshëm, pasi ai minor rëndësi sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar dhe është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar. Aleatët e NATO-s i bëjnë thirrje Rusisë që të ndalojë menjëherë luftën, të tërheqë të gjitha forcat e saj nga Ukraina dhe të angazhohet në diplomaci të vërtetë. Aleanca dënon gjithashtu përpjekjen e paligjshme të Rusisë për të aneksuar katër rajone të Ukrainës, Donetsk, Luhansk, Kherson dhe Zaporizhzhia. Referendumet e rreme në këto rajone u projektuan në Moskë dhe u imponuan Ukrainës. Ata nuk kanë legjitimitet dhe NATO nuk do t'i njohë. Këto toka janë Ukrainë dhe do të jenë gjithmonë Ukrainë. NATO qëndron përkrash popullit të Ukrainës dhe presidentit, parlamentit dhe qeverisë legjitime, të zgjedhur në mënyrë demokratike. Aleanca do të mbajë gjithmonë mbështetjen e saj të plotë për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht.

Dita e Verës, tradita që i rezistoi shekujve

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë. Festimet kryhen në nderim të natyrës së bukur shqiptare dhe bimësisë që merr jetë në këtë datë. Tashmë kjo festë është bërë edhe ditë kombëtare pushimi. Shenja dalluese e këtij festimi është gatimi i ballokumeve. Ndërsa në disa vende të tjera Ditën e Verës ndizeshin zjarre purifikues për t'i dhënë forcë diellit në oborr e në kopshte. Nga gratë bëheshin rite magjike e kundër qenieve të tjera dëmtuese, grabitëse. Nata dhe Dita e verës është një nga traditat e shqiptarëve, po ashtu ne nuk duhet të sforcohem këtu ditë apo të bëjmë ndonjë gjë që të ndjehemi të lodhur. Ndonëse kjo ditë vazhdon të ruhet dhe festohet madhërisht në qytetin e lashtë të Elbasanit, ajo është festë e të gjithë shqiptarëve. Më 13 mars njerëzit marrin një tufë të vogël bari të njomë bashkë me rrënjët dhe dheun, që ta kenë në mëngjesin e datës 14 mars në shtëpi. Ky zakon i lashtë ruhet dhe festohet jo vetëm në Elbasan por edhe në vendet e tjera. Dita e Verës ishte dita e fillimit të vitit sipas kalendarit shumë të lashtë të shqiptarëve, pra një ditë që kremtohej shumë shekuj para se të lindte krishterimi. Ajo kremtohej me 1 mars të kalendarit Julian, ditën e parë të vitit të ri (sipas kalendarit Gregorian, "14 mars"). Ajo ishte një festë mbarë shqiptare, që kremtohej si në Veri edhe në Jug, por me nuanca të ndryshme, sipas krahinave. Si dëshmi po sjellim këtu dy përshkrime të kuptimit dhe krenimit të Ditës së Verës, njëra për krahinat jugore, tjetra për malësitë veriore. Janë përshkrime të botuara në kohën kur në Shqipëri nuk kishte parti politike, madje në kohën kur as institucionet klerikale nuk futnin hundët në kremtime të ashtuquajtura pagane.

Përshkrimin e parë e kemi nga i madhi Faik Konica. Ç' është Dita e Verës?

"Është dita në të cilën stërgjyshërit tanë, kur s' kish lindur edhe krishtërimi, kremtojnë bashkë me Romanët dhe me Grekët e Vjetër, perëndit' e luleve, të shelgjeve, të krojeve. Kur çkrin dimëri, kur qaset Vera buzëqeshur e hollë dhe e gjatë si në piktyrë të Botticelli, zemra e njeriut çgarkohet nga një barë, shijon një qetësi, një lumtësi t'ëmbëlë. Në këtë gëzim, stërgjyshërit t'anë ndiejn një detyrë t'u falen perëndive që sillnin këto mirësira. Dhe ashtu leu festa hiroshë që quajmë Dit' e Verës."

Përshkrimin e dytë, i cili flet për krenimin e "Ditës së Verës" nga malësorët katolikë të veriut, e kemi nga At Berdardin Palaj. Ai shkruante dy dekada pas Faik Konicës:

"Shtëpi më shtëpi në ditët e veravet, pjesëtarët e familjes bashkoheshin rreth zjarrit për me lidhë shtrigat, mgjillcat, llungjat, rrollcat e të gjitha shtazët dëmtuese: gjarprin mos ti nxajë, lepurin mos t'u hajë loknat e bathën, e shpendin emën për emën e krimbat e tokës mos t'u mbajnë dam ndër ara. Tri ditë përpara veravet duhet me mshefë shoshat, sitat, furkat e me çartë krojet, në mënyrë që mos me i pamë këto sende asnjë rob i shtëpisë, pse për ndryshje nul lidhet gja. Këto ditët e veravet bijnë gjithmonë ndër ditët e para të marsit. Mbas darkë, të gjithë pjesëtarët e shtëpisë bashkohen rreth zjarrit. I zoti i shtëpisë merr një pe të zi leshti, e lidhë për vergue një nyje e thotë këto fjalë. Lidhe Zot nata e mojt e dita e verave! Unë pak e Zoti shumë! Po lidhim shtrigat. Kështu përsërit këtë veprim për secilin shpirt damtues, sëmundje, krimba e kodra që don me lidhë."

Festimet e kësaj ditë në Dibër fillojnë dy javë përpara, ku djemtë e rinj gjatë ditës shkojnë në mal dhe presin dëllinja, të cilat i sjellin në fshat, për të formuar një ose më shumë mullarë. Këta mullarë me dëllinja vendosen kryesisht në pika më të larta të fshatit, në mënyrë që zjarri të jetë sa më i lartë duke u bërë konkurrencë të dukshme fshatrave të tjerë përreth.

Kur, dielli ulet dalëngadalë nga horizonti, duke u zëvendësuar nga hëna, të rinjtë afrohen rreth mullarëve të dëllinjave, dhe presin momentin që t'i vënë zjarrin. Sapo zjarri ndizet, djemtë gjuajnë me bahe (është mjet i trashëguar brez pas brezi dhe që bëhet në mënyrë artizanale, e cila hedh prej një distance relativisht të largët gurë që kanë përmasa mesatare) për të larguar dhe vrarë të keqen, në mënyrë që pranvera të jetë më reshje të bollshme, për siguruar të korra të mira me shumë "beregë", nga të cilat do të krijohen rezerva të bollshme për të kaluar periudhën e gjatë të dimrit. Kurse, vajzat këndojnë rapsodi të trashëguara dhe të transmetuara brez pas brezi që i kushtohen Ditës së Verës. Ky ritual vazhdon deri më datë 14 mars.

Më 14 mars, në mëngjes vendoset një garë e pashpallur kush zgjohet më shpejt në mëngjes (sipas traditës ai që zgjohet më vonë do t'i shkojë i gjithë viti në të shumtë në kohës në gjumë), familjet që zgjohet më vonë zakonisht kanë edhe një ndëshkim



simbolik, iu mbyllet nga jashtë dera e shtëpisë. Pasi zgjohet, të rinjtë dalin për të mbledhur lule si kukreka, lule thane, shelgje etj., të cilat i vënë mbi portën hyrëse si dhe brenda shtëpisë. Kurse vajzat ziejnë vezët dhe i ngjyrosin me mozaikun e ngjyrave. Vezët rroket mes të rinjve me fitimas (që do të thotë se ai që ka vezën me të fortë ja fiton dhe ja merr ati që i thyhet).

Këto ngjarje ndodhin zakonisht në një livadh ose në qendër të fshatit, ku përveç këtyre riteve bëhen edhe mjaft lojëra të tjera si: "Kala Dibrane", mundje mes djemve të rinj e etj. Gjatë paradites nënat përgatisin drekën e bollshme, ku një vend të veçantë zë flija (gatim tradicional kryesisht i zonës së Dibrës). Pas drekës, njerëzit dalin për vizita tek të afërmit. Kështu mbyllet festimi i Ditës së Verës, si një festë që sjell vetëm gëzim, harmoni dhe lumturi në familjet tona.

Vitet e fundit Dita e Verës është bërë me të vërtetë një festë mbarëkombëtare, ku festohet masivisht nga të gjithë shqiptarët pa dallim moshe, besimi fetar dhe krahinor. Kjo tregon se shqiptarët edhe në festa janë të bashkuar, si një trung i vetëm, duke treguar se janë një komb i vetëm dhe që kanë vetëm një identitet, atë shqiptar, i cili rrjedh nga qytetërimi antik Ilir, ndër më të vjetërit, jo vetëm në Ballkan por edhe në Evropë. Dita e Verës e vërteton këtë lidhje, sepse vetë Dita e Verës është shumë e lashtë për nga koha e krenimit dhe mënyra. Është festë pagane që rrjedh nga lashtësia dhe që është ruajtur me shumë fanatizëm deri në ditët tona. Natyrisht që nga fillimet e krenimit të saj deri sot, kohët kanë ndryshuar dhe për rrjedhojë edhe mënyra e festimit, por forma e saj bazë është po e njëjta, ka qenë dhe mbetet një festë pagane, me origjinë dhe traditë shqiptare dhe që i dedikohet stinës së pranverës, me të cilën rigjallërohet gjithçka pas një gjumi të lodhur dhe të gjatë dimëror.

Dita e Verës njihet si festa e gjithë shqiptarëve, por Elbasani dhe ballokumja është zemra e saj. Një feste pagane, qe e ka origjinën në kohën kur njerëzit i faleshin perëndive. Tempulli ka qenë në zonën e Çermenikës, në afërsi të Librazhdit të sotëm. Në kalendarin e vjetër, njerëzia orientohej në Diellin, Hënë dhe

gjelbërimin. Ndërsa sot është fiksuar 14 marsi, ditë e festës së lashtë, që shënon ndryshe fundin e dimrit të acartë dhe hyrjen e pranverës së çeljes së luleve. Në kohën antike, të parët tanë, Ilirët, udhëtonin nga të katër anët për t'iu falur perëndisë së ripërtëritjes dhe gjithësisë, Diana Candeviensis. Dita e Verës është festë e të gjithëve, e të pasurve dhe të varfërve, është festë mbarë popullore, ku të gjithë gëzojnë. As feja, as ideologjia dhe së fundi as politika, nuk mundën ta kenë të tyre. Kohët shkuan dhe tempulli i festës qëndroi në Elbasan, në qytetin e luleve dhe këngës, të dashurisë dhe begatisë. Duhet theksuar edhe një herë, që dt. 14 mars thjesht hap festivalin njëjavor të pjellorisë dhe rilindjes së natyrës, duke çuar drejt 21 marsit, që është Dita kalendarike diellore e Verës. 14 marsi është Dita e Verës për Shkumbinin dhe, për shumë vjet me radhë dhe Tiranën, por krahinat e tjera shqiptare kanë secila Ditë të tyre të Verës brenda kësaj jave që mbahet në formë festivali në gjithë trojet. Vjet p.sh., qyteti i Shkodrës festonte në dt. 15 mars. Caktimi i datës kryhet krejt nga ana praktike, duke marrë parasysh ditën më të qëndrueshme me diell brenda kësaj jave për secilën krahinë. N.q.s. vihet re në krahinat e Shqipërisë së Mesme, 14 marsi ka qenë gjithnjë ditë me diell dhe e ngrohtë, ndërsa ditët e më pasme shpesh janë me re dhe madje dhe shi.

Duke synuar një ditë të tillë, secila krahinë në bazë të nën klimës së vet cakton një datë me ditën më të qëndrueshme të diellit, brenda kësaj jave. Data mund të puqet dhe me një a më shumë krahina të tjera, por gjithnjë në vartësi të anës praktike dhe nuk është e thënë që secila krahinë të ketë doemos datën e vet. Është klima vendore që ka fjalën e fundit dhe për këtë është e nevojshme njohja e zonës, pasi festimi është organik dhe jo artificial. Për këtë arsye dhe mënyra e festimit ndryshon sipas krahinave, gjë që i jep dhe bukurinë e vet festivalit në rang kombëtar. Prejardhja e Ditës së Verës është e lidhur me Ilirët, të cilit festonin Ditën e Verës, më 15 mars, në shenjë adhurimi ndaj Diellit, po të shohim bollokumet kanë ngjyrën dhe formën e Diellit.

Ballokumja



Ballokumja Elbasanit

Ballokumja është ëmbëlsire karakteristike vetëm në Elbasan. Ka qenë dhe është sinonim i Ditës së Verës. Ka një formulë të veçantë gatimi, e njohur vetëm në këtë qytet. Në vija të përgjithshme, një ballokume përgatitet si vijon:

- Në një enë të posaçme prej bakri futen sipas radhës gjalpë i freskët, sheqer, vezë, maja mielli misri dhe pak finje zjarri.

Të gjitha asortimentet përzgjidhen në kushte natyrale. Gjalpi duhet të jetë prodhuar në fshat dhe të këtë një ngjyrë të veçantë. Gjalpi i freskët tretet dhe vendoset në enën e ballokumes. Mbi gjalpë hidhet pak e nga pak sheqer dhe të dyja rrihen gjatë me një lugë druri. Më pas hidhen vezët një e nga një, ndërkohë që rrahja me lugë vazhdon. Pastaj e ka radhën hedhja e majasë së miellit të misrit. Majaja e miellit hidhet me ngadalë dhe përzihet vazhdimisht me lugën e drunjte. Në masën e formuar hidhet pak finje zjarri. Rrahja duhet të bëhet me dorë. Brumi i formuar nga kjo përzierje merret me lugë druri dhe vendoset në topa në tepsi dhe futet në furrën me dru zjarri. Piqet dhe shërbehet në formën e kulaçeve.

Rituali i Ditës së Verës, katër fazat e festës

Festa pagane ka ritualin e saj. Ritet janë trashëguar brez pas brezi ndoshta për 24 shekuj me radhë. Dikur dedikimet i kushtoheshin perëndeshës Diana, sot ato praktikohen për një jetë më të mirë të mbushur me gëzim, dashuri dhe begati. Studiuesi dhe muzikologu i njohur Thanas Meksi e ndan në katër faza festën e Ditës së Verës. Faza e parë është faza përgatitore, që nis me grumbullimin e zaireteve që janë të nevojshme për Ditën e Verës. Faza e dytë është nata e Verës që nis më 13 mars me zjarrin, faza e tretë, mëngjesi i Ditës së Verës, që nis më 14 mars dhe së fundi pikniku i Ditës së Verës, në mesditën e 14 marsit. Në vigjilje të natës së Ditës së Verës, çdo shtëpi e këtij qyteti është e mbushur me një gëzim të veçantë, është një ndjesi që i pushton njerëzit fare pa e kuptuar. Ndoshta nga ndikimi i diellit, gjelbërimit apo shpërthimit të farës dhe sythave, që janë shprehje e begatisë dhe vazhdimësisë. Shtëpia mbushet plot me gjëra të mira dhe me bollëk. Porta zbukurohet me lule dhe lastarë të gjelbër, të cilët simbolizojnë futjen e mirësisë dhe natyrës. Gjatë kësaj nate të afërmit, por edhe shokë e miq të ardhur nga viset e tjera, këndojnë këngë të vjetra të shoqëruar me kuzhinën me nam të Elbasanit. Disa nga gjellët, që nuk i gjen në vend tjetër, janë tava me pistil, tava e kosit, kabunia, çomleku, gjeli i detit etj. Gjatë kësaj nate fillon të ndahet edhe hiseja e nesërme për njerëzit më të afërm. Mëngjesi është i gëzuar dhe festiv. Elbasanasit zgjohen herët, më 14 mars, dhe me një përkushtim të veçantë hapin derën që të futet e mira dhe të dalë e liga.

“Buka e derrit”

Sytë lahen me lulet e verës, me manushaqe dhe me karakaftë (lloj luleje) dhe më pas pihet ujë në “bukën e derrit”, që është një zhardhok që gjendet në tokë, në zonat me pyje dhe gjelbërim. Uji në “bukën e derrit” simbolizon një vit të shëndetshëm dhe të

begatë. Gjithashtu, një zakon tjetër që ruhet në këtë ditë, është zierja e vezëve natën e datës 13, dhe larja e syve me ujin e vezëve të ziera në mëngjesin e Ditës së Verës. Veç kësaj, Ditën e Verës, lidhet në dorë një “verore”, që është si byzylyk i formuar prej një fijeje të kuqe dhe një fijeje të bardhë. Verorja hiqet kur sheh dallëndyshen e parë, dhe hidhet në ferra që dallëndyshja ta marrë për të bërë fole. Të gjitha këto janë rite që kryhen për të kremtuar ardhjen e pranverës, çeljen e luleve, rikthimin e dallëndysheve e gjallërimin e jetës.

Vizitat

Mëngjesi i 14 marsit nis me vizitat tek të afërmit, ku djali më i vogël i familjes nxiton të dërgojë hisen e ndarë. Pikniku nis në orën 10:00. Por vitet e fundit aktivitetet për rastin e festës nisin një orë më parë. Në piknikun e Ditës së Verës elbasanasit lënë qytetin dhe u drejtohen pikave turistike në Byshek, Gjinar, Gurrën e Labinotit, Ullirit të Qefit, Kroit të Kalit, Çezmës së Lepurit, Ujit të Ftohtë në Labinot, llixhe etj.

Kopshtarët e luleve dhe këngët e traditës

Dita e Verës nuk ka kuptim pa lulet dhe këngët. Prej kohesh elbasanasit njihen si kopshtarë me nam dhe këngëtarë të shpirtit. Lulet më karakteristike në Elbasan janë jasemini, karafili, trëndafil, zymbyli, karakaftet etj. Kultivuesit kujdesen për lulet në mënyrë që ato të shpërthejnë Ditën e Verës. Vitet e fundit ansambli i luleve është pasuruar me trëndafila dhe karafila të ardhur nga disa vende të botës, nga Egjipti deri në Holandë. Gjatë natës dhe Ditën e Verës këndohen me pasion të veçantë këngët e mjeshtër të muzikës popullore qytetare Isuf Myzyrit. Këngë të tilla si: “Një lulishte me trëndafila”, “Ç’u dëshiruesh me të pa”, “Ma mirë n’ pyll se sa n’ qytet”, “Si bilbili në pranverë” etj., këndohen jo vetëm nga elbasanasit, por në mbare trojet shqiptare.

Koha dhe ritet sot, çfarë ka ndryshuar

Nga viti në vit, festa pasurohet me gjërat që burojnë nga shpirti i vetë njerëzve. Më 14 mars, Elbasani kthehet në epiqendrën e pelegrinazhit. Festa ka një ndikim të çuditshëm tek të gjithë. Jo vetëm shtëpitë, por i gjithë qyteti vishet me dekor shumëngjyrësh, ashtu si lulet e pranverës. Në vigjilje të festës, ndërmarrja e dekorit zbukuron rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit. Ndërsa ndërmarrja e gjelbërimit mbjell lule dhe sipërfaqe të gjelbëruara. Për çdo vit bashkia Elbasan akordon një fond të veçantë për festën. Në pikat turistike dhe në parqe janë programuar të organizohen koncerte, lojëra popullore, pjesë humori etj.

Dibër

Përveç Ditës së Verës, dibranët festojnë dhe Natën e Verës, ku gjithë qyteti duket sikur e ka pushtuar djalli me zjarret e ndezur. Ku fëmijët e vegjël bëjnë parapërgatitje 1 vit përpara, duke mbledhur goma që pikërisht të ndizen Natën e Verës. Zjarri në fakt është karakteristikë e pothuaj të gjitha trevave shqiptare. Pas kësaj vjen dhe më e bukura, një tjetër karakteristikë për këtë krahinë të madhe shqiptare të bën të mendosh për natyrën pagane të kësaj feste dhe mbi të qenit supersticioz, të shqiptarëve, ku njerëz nga më të ndryshmit bëhen të gjithë rebelë për një natë, duke u

mbyllur dyert e shtëpive në qytet dhe fshatrave. Të nesërmen është dita kur thyhen me mijëra vezë, derisa të dalë veza fituese, më e forta nga të gjitha. Është dita kur nëna na bën (siç thonë dibranët) “fërci, fërci nona, u bëfsh ma i fort se thona”. Është dita kur njerëzit dalin dhe festojnë fushave të bukura me lule dhe gjelbërim, jo asfalteve të mbushur me pluhur!

Nartë, Vlorë

Në fshatin Nartë, çdo vit, si një shenjë mirëseardhjeje të ditëve verore, organizohen karnavalet, një festë kjo që tashmë bashkon komunitetin e kësaj zone në fshatin që po braktiset. Banorët thonë se kjo festë fetare ka marrë jetë nga viti 1922. Sipas banorëve dhe gjatë regjimit komunist, ku të tilla festa u ndaluan, karnavalet në Nartë bëheshin edhe fshehurazi. Besimtarët ortodoksë në këtë fshat janë shumë të dhënë pas kësaj feste, çka duket tek mënyra se si i organizojnë, pjesëmarrja e tyre masive, madje dhe shqiptarët emigrantë vijnë nga vendet fqinje për të qenë të pranishëm në këtë ditë pranë vendit të tyre.

Tropojë

Kjo stinë në Tropojë grumbullon shumë njerëz në fshatin Luzhë, ku ata kërkojnë ndihmë dhe mbarësi nga tyrbe të kthyer tashmë në idhuj. Të mëdhenj dhe të vegjël udhëtojnë me kilometra në terrene malore për të mbërritur në këto tyrbe vërtetë të shenjta dhe hyjnore.

Shqipëri e mesme

Këtu edhe mendohet se ka lindur e ashtuquajtura Dita e Verës. Në Elbasan përmasat festive janë më të mëdha se kudo tjetër. Ato marrin karakter popullor dhe pjesëmarrja është në nivel shtetëror. Këngë, valle, turma që mbushin qytetin, vezë të ziera të lyera me lloj-lloj ngjyrash, dhe ëmbëlsirat e famshme të quajtura ballokume që mbushin tregjet. Kjo festë në fakt quhej e tillë vetëm në Elbasan dhe për zyrtarizimin e kësaj feste nga Elbasani pati xhelozitë. Qytetin e Elbasanit e vizitojnë këtë ditë qytetarë nga shumë qytete të vendit.

Skrapar dhe Lushnjë

“Verore” quhet peri që lidhet në kyçin e dorës dhe zgjidhet kur të shikohet dallëndyshja e parë. Veroret bëhen me pe ngjyrë të bardhë dhe të kuqe. Këto dy ngjyra simbolizojnë pastërtinë e shpirtit dhe shëndetin. Pasi zgjidhet mendohet një dëshirë dhe më pas peri hidhet në një ferrë ose trëndafil, apo vendoset në degën e një peme me shpresën që një dallëndyshe të vijë ta marrë për të ndërtuar follenë e saj dhe kështu të realizojë dëshirën e menduar. Kjo praktikohet edhe në Skrapar dhe Lushnjë.

Në këtë ditë fëmijët në Skrapar shkojnë derë më derë, duke kënduar këngën e Ditës së Verës, ndërsa iu jepin si dhurata vezë të ngjyrosura, të cilat i thyjnë nëpër koka. Gatimi tipik i Skraparit për këtë festë, përveç ballokumeve është edhe anak (lakrorë) me hithra. Ashtu si edhe në Tropojë dëllinjave u vihet flaka në mbrëmje, për të bërë sa më shumë tym dhe me tymin t’i jepet lamtumira të vjetër dhe të këqijave, ndërsa fëmijët këndojnë dhe hedhin valle rreth zjarrit.

Në Lushnjë bashkë me vezët zihet edhe misri e gruri, se sa misër zihet e dinë gratë lushnjare, që duhet t’u japin fëmijëve që vijnë duke këndur dhe duke përplatur dy gurë më njëri-tjetrin. Ata kërkojnë misër ose vezë të ziera. Megjithatë në Lushnjë Dita e Verës nuk festohet gjithmonë më 14 mars, në fakt për ortodoksit festohet më 1 mars, më 14 e festojnë myslimanët.

Korçë

Korça së bashku me Kolonjën janë zona që përdorin të dyja kalendarët për festimin e Ditës së Verës. Në këto zona festohet edhe më 1 mars edhe më 14 mars. Veçanërisht më datën 14 mars, në këto zona çelet vërtet moti dhe mbrëmjen para se të bjerë dielli i ditës së 14 marsit, të vegjlit dhe të rinjtë e Korçës dalin nëpër lagjet e qytetit dhe ndezin zjarre. Tradicionalisht fëmijët nëpër mëhalla bëjnë garë kush e kush të gjejë më shumë shkarpa të bëjë zjarrin më të madh. Pastaj për mbarësi të gjithë përpiqen të kapërcëjnë zjarrin si simbol i kapërcimit me sukses të të ftohtit të dimrit dhe rigjallërimit dhe ndezjes së gjakut që sjell vera. Nënat dhe gjyshet nëpër shtëpi bëjnë kuleçë me kripë ose të ëmbla, duke nënkuptuar jetën, gjallimin dhe bollëkun. Më datë 14 fëmijët, dhe jo vetëm, dalin me vezë të ngjyera nëpër duar dhe me verore. Verorja - Zakon popullor

Më 1 mars, në fshatrat dhe qytetet e krahinës së Korçës, fëmijëve dhe beqarëve djem e vajza u jepej një si rreth dore a varëse, e bërë me fill të tjerrur të kuq e të bardhë, term që ndoshta ka lidhje me emrin e stinës ‘verë’ në shqip. Në fund të ditës, vajzat i linin ato në degë peme ose në shkurre. Në qoftë se zogjtë i merrnin ato verore për të bërë fole, atëherë mendohej se vajza do të martohej brenda vitit. Ky zakon ruhet akoma për të gjitha moshat. Zakonisht besimtarët bektashinj e heqin veroren më datë 23 mars, ditën e Sulltan Nevruzit dhe e vendosin atë në pemët e Teqesë së Turanit, një fshat afër Korçës, ose e heqin me të parën e dallëndysheve së parë. Nëse nuk shkohet dot në Teqe, verorja e hequr vendoset në një shkurre a pemë.

Çfarë është Forca Hapësinore e SHBA-ve dhe për çfarë shërben ajo?

Ndoshta logoja e kësaj force duket sikur është vjedhur nga seriali fantastiko-shkencor “Star Trek”, emri tingëllon sikur është përshtatur nga “Guardians of the Galaxy” dhe uniformat e tij duket se janë hequr nga “Battlestar Galactica”.

Në fakt, ky tashmë është një realitet, ushtria amerikane ka një forcë tjetër, e cila përfshin hapësirën, përveç forcave të tjera ekzistuese të Mbrojtjes.

Forca Hapësinore e Shteteve të Bashkuara u krijua si dega e gjashtë dhe më e re e Forcave të Armatosura të SHBA-së, më 20 dhjetor 2019. Para kësaj, Shtetet e Bashkuara nuk kishin krijuar një degë të re ushtarake që nga viti 1946, kur u ngrit Forca Ajrore.

Siç shpjegon Space Force në faqen e saj të internetit, fokusi i saj është mbrojtja e sistemeve të bazuara në hapësirë që po përdorim tashmë këtu në Tokë, jo kërkimi i jetës së re dhe qytetërimeve të reja (që është ende puna e NASA-s): “Qasja e papenguar në hapësirë është jetike për mbrojtjen kombëtare. Sistemet hapësinore janë thurur në strukturën e mënyrës sonë të jetesës. Hapësira ndikon pothuajse në çdo pjesë të jetës sonë të përditshme dhe është thelbësore për sistemin tonë ekonomik. Për shembull, satelitët jo vetëm që fuqizojnë teknologjinë GPS që ne përdorim çdo ditë, por na lejojnë të shfletojmë në internet dhe të telefonojmë miqtë tanë, duke u mundësuar reaguesve të parë të komunikojnë me njëri-tjetrin në kohë krize, transaksione me afat kohor në tregun financiar botëror dhe madje na lejon të përdorim kartat e kreditit në karburante”.

Shtytja për një degë të dedikuar të shërbimeve të armatosura kush-tuar kufirit përfundimtar fitoi vlerësim ndërsa hapësira orbitale u bë gjithnjë e më e populluar dhe e kontestuar nga njerëzit. Ndërsa infrastruktura kritike e Shteteve të Bashkuara u bë gjithnjë e më e varur nga satelitët për komunikimin, navigimin, meteorologjinë dhe inteligjencën, Departamenti Amerikan i Mbrojtjes identifikoi gjithashtu nevojën për një degë të ushtrisë të dedikuar vetëm për funksionimin dhe mbrojtjen e këtyre asetëve. Kështu, u krijua Forca Hapësinore.

Motoja e shërbimit, “Semper supra”, është latinisht për “Gjithmonë lart”, një frazë që përmbledh misionin e Forcës Hapësinore. Simboli i saj, Delta, nënkupton përgjegjësitë dhe misionin e shërbimit, duke nderuar historinë e tij të gjatë që filloi shumë përpara se të krijohet Forca Hapësinore në 2019.

Historia e Forcave Hapësinore të SHBA-së daton në vitin 1954, kur Forcat Ajrore e SHBA-ve krijoi një divizion të ngarkuar me mbikëqyrjen e raketave balistike të ushtrisë amerikane. Kjo ndarje evoluoi disa herë gjatë dekadave në vijim dhe u bashkua me organizata të tjera, pasi Shtetet e Bashkuara filluan të vendosin më shumë satelitë në orbitë për sistemet e komunikimit dhe paralajmërimit të hershëm të raketave. Në vitin 1982, Forcat Ajrore ngritën Komandën Hapësinore të Forcave Ajrore, duke e bërë atë komandën e parë operacionale hapësinore



në Forcat e Armatosura të SHBA-ve. Komanda Hapësinore e Forcave Ajrore vazhdoi të rritet nga vitet 1980 e tutje, ndërsa Departamenti i Mbrojtjes (DOD) u përpoq të konsolidonte operacionet e tij hapësinore.

Më 20 dhjetor 2019, Komanda Hapësinore e Forcave Ajrore u riemërua Forca Hapësinore e Shteteve të Bashkuara dhe u krijua si një shërbim i pavarur kur ish-Presidenti Donald Trump nënshkroi Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare 2020. Publikimi i parë nga ish-presidenti Trump, i krijimit të kësaj Force u prit me komente dyshuese e madje edhe qesharake nga një pjesë e madhe e popullsisë amerikane:

“Fushata e Presidentit Trump dëshiron që njerëzit të votojnë për një logo të për Forcën e re Hapësinore... Duke lënë mënjanë pyetjet në lidhje me përshtatshmërinë e gjithë kësaj, mos harroni se mund të mos ketë kurrë një Forcë Hapësinore”, - shprehej në atë kohë Justin Fishel, korrespondent i Lartë i ABC News, për Shtëpinë e Bardhë.

Sipas strukturës së nënshkruar në ligj, Forca Hapësinore do të ishte pjesë e Departamentit të Forcave Ajrore të SHBA-së, ashtu si Trupat e Marinës së Shteteve të Bashkuara, të cilat janë pjesë e Departamentit të Marinës së SHBA-vë.

Në krijimin e saj, 16 000 personel ushtarak dhe civil u caktuan në Forcën Hapësinore. Që nga janari 2023, shërbimi përbëhet nga 4 286 anëtarë të shërbimit të regjistruar dhe 4 314 oficerë, sipas “Air Force Times”, duke e bërë atë degën më të vogël të ushtrisë amerikane. Marina e SHBA-së, për krahasim, ka mbi 300 000 anëtarë aktivë në detyrë, ndërsa Ushtria e SHBA-së krenohet me afër 500 000 anëtarë aktivë të shërbimit.

Anëtarët e shërbimit të Forcave Hapësinore njihen si “Guardians”, një emër i shpallur në një ceremoni të vitit 2020 që shënon përvjetorin e parë të shërbimit. Uniformat e shërbimit u debutuan në një ceremoni të shtatorit 2021, duke zbuluar se ato ishin një tunikë me dy krahe me gjashtë kopsa që bën krahasime me kostumet e veshura në serialin fantastiko-shkencor “Battlestar Galactica”.

Çfarë bën Forca Hapësinore?

Sipas deklaratës së misionit të

Forcës Hapësinore të SHBA: “Shërbimi është përgjegjës për organizimin, trajnimin dhe pajisjen e Gardianëve për të kryer operacione hapësinore globale që përmirësojnë mënyrën se si forcat tona të përbashkëta dhe të koalicionit luftojnë, duke u ofruar gjithashtu vendimmarrësve opsionet ushtarake për të arritur objektivat kombëtare”.

Për të përmbushur këtë mision, Forca Hapësinore është e organizuar në tre divizione kryesore: Komanda në terren, Delta dhe skuadrone. Tre komandat në terren të shërbimit janë Komanda e Operacioneve Hapësinore (SpOC), Komanda e Sistemeve Hapësinore (SSC) dhe Komanda e Trajnimit dhe Gatishmërisë në Hapësirë (STARCOM). Komandat në terren mbikëqyrin qëllimet e gjera të misionit.

Komanda e Operacioneve Hapësinore, për shembull, është përgjegjëse për ofrimin e aftësive hapësinore të gatshme luftarake, operacioneve kibernetike dhe inteligjencës në mbështetje të operacioneve ushtarake të SHBA-së.

Ndërkohë, Komanda e Sistemeve Hapësinore është përgjegjëse për zhvillimin e shërbimit dhe përvetësimin e teknologjive dhe aftësive të reja hapësinore. Faqja e internetit e komandës shkruan se SSC ka për detyrë zhvillimin, blerjen, pajisjen, vënien në terren dhe ruajtjen e aftësive hapësinore vdekjeprurëse dhe elastike për luftëtarët. Ky mision përfshin mbikëqyrjen e operacioneve të nisjes dhe mirëmbajtjen në orbitë të satelitëve DOD dhe sistemeve të tjera hapësinore.

Komanda e Trajnimit dhe Gatishmërisë në Hapësirë, ose STARCOM, siç sugjeron emri i saj, ka për detyrë të edukojë dhe trajnojë personelin e Forcave Hapësinore për të luftuar dhe fituar në një mjedis të kontestuar, të degraduar dhe të kufizuar operacionalisht përmes zhvillimit, edukimit dhe trajnimit të qëllimshëm të profesionistëve të hapësirës; zhvillimi i doktrinës, taktikave, teknikave dhe procedurave të luftimeve në hapësirë; dhe testimi dhe vlerësimi i aftësive të USSF-së.

